



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL**

Kontrolli i Lartë i Shtetit rihap procedurën e pranimit për plotësimin e **1 (një) vendi vakant “Auditues i Dytë në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm”**.

**I. Përshkrimi i punës për pozicionin “Auditues i Dytë në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm”**

Audituesi i Dytë në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në KLSH kryen këto detyra kryesore:

1. Përgjigjet dhe jep llogari para Drejtorit të Drejtorisë.
2. Mbi bazën e të dhënave të rezultateve të auditimit të brendshëm, në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë përgatit analizat dhe raportet periodike tremujore të Drejtorisë.
3. Gjatë veprimtarisë audituese mban dhe përgatit procesverbale apo aktverifikime, gjithashtu në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të grupit të auditimit harton projektraport auditimi, raportin përfundimtar të auditimit, si dhe projektvendim për marrjen e masave.
4. Për nevoja auditimi, audituesi i brendshëm tërheq kopje të dokumenteve, hyn dhe verifikon në vend, në depo, magazina, njësi ose objekte pa asnjë kufizim, verifikon dhe vlerëson kudo që ndodhen vlera materiale e monetare në pronësi të KLSH-së, duke respektuar rregulloren e brendshme të institucionit dhe programin e auditimit.
5. Nëse gjatë procesit të auditimit konstaton veprime apo mosveprime për të cilat arsyeton se ka elementë të veprës penale është i detyruar të njoftojë menjëherë drejtorin e drejtorisë dhe ky i fundit Kryetarin, duke bllokuar dokumentacionin e nevojshëm.
6. Kur vërteton shkelje, dëme dhe parregullsi, audituesi sipas rastit propozon masa me karakter organizativ, administrativ dhe disiplinor si dhe shpërblim dëmi.
7. Merr masa për përgatitjen dhe kualifikimin profesional, si dhe për përditësimin rregullisht të njohurive dhe aftësive profesionale, për të garantuar cilësinë e shërbimit të auditimit të brendshëm.
8. Plotëson dosjen e auditimit, aneksin për ndarjen e çështjeve të audituara, nënshkruan inventarin që përmban dosja e auditimit.
10. Etj.

**II. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati dhe kriteret e veçanta**

*Kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:*

- Të jenë diplomuar jo më poshtë se niveli Master Shkencor në Shkenca Juridike;
- Të jenë të certifikuar si “Auditues të Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Të kenë përvojë pune në fushën profesionale minimumi 10 vjet;
- Të zotërojnë kualifikime që lidhen me fushën profesionale;
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze;
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunuese për të punuar në grup.

Kategoria e pagës për këtë vend pune është III-2.

**III. Paraqitja e dokumenteve**

Kandidatët që shprehin interesin për të aplikuar duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesë;
- Jetëshkrimin e përditësuar me të dhëna të plota;
- Fotokopje të noterizuar të diplomës së nivelit Bachelor dhe Master Shkencor së bashku me listën e notave;
- Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht sipas legjislacionit në fuqi për njehsimin e diplomave;
- Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim për bazën e vlerësuar;
- Fotokopje të letërnjoftimit;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Për kandidatët që gëzojnë statusin e Nëpunësit Civil:
  - Vërtetim që nuk kanë masë disiplinore në fuqi;
  - Vlerësimin e fundit të performancës në punë “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Çdo dokument tjetër që vërteton njohuritë e gjuhës së huaj, trajnimeve, kualifikimeve, arsim shtesë si dhe vlerësime pozitive të përmendura në jetëshkrim.

***Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës 20.09.2024.***

#### **IV. Faza e verifikimit paraprak**

Në faqen zyrtare të KLSH-së [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al) më datë **25.09.2024** do të bëhet shpallja e listës së verifikimit paraprak për kandidatët që plotësojnë kriteret e shpallura të vendit të punës. Kandidatët që nuk do të kualifikohen do të njoftohen me email po në të njëjtën ditë. Njoftimi do të dërgohet për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

#### **V. Konkurrimi**

*Kandidatët do të vlerësohen me shkrim mbi njohuritë në lidhje me:*

- Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
- Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së;
- Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së;
- Kuadrin rregullativ për auditimin e brendshëm.
- Kuadrin rregullativ për prokurimet publike;

*Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen lidhur me:*

- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën lidhur me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Zbatimin e kuadrit rregullativ në funksion të pozicionit në KLSH;
- Eksperiencat e tyre të mëparshme lidhur me pozicionin e punës;
- Vizioni, motivimi dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

#### **VI. Fazat dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Kandidatët do t'i nënshtrohen fazave të vlerësimit si, verifikimi paraprak dhe vlerësimi i kandidatëve. Verifikimi paraprak, ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Vlerësimi i kandidatëve, përfshin:

- a) vlerësimi i dokumentacionit (arsimimi, përvoja, trajnime të lidhura me fushën);
- b) vlerësimi me shkrim;
- c) intervista e strukturuar me gojë.

Në përfundim të procesit të vlerësimit vetëm kandidatët që do të grumbullojnë të paktën 70% të pikëve totale do të shpallen fitues.

## **VII. Njoftimi i kandidatëve**

Në faqen zyrtare të KLSH-së, [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al) më datë **25.09.2024** do të bëhet shpallja e listës së verifikimit paraprak, data mbi zhvillimin e testimit me shkrim, dhe intervistës së strukturuar me gojë. Kandidatët që nuk do të kualifikohen do të njoftohen me email. Njoftimi do të dërgohet për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

*Konkurrimi është i hapur për nëpunësit civil që plotësojnë kriteret e veçanta të shpallura.*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**